

Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë



2

“Integriteti, transparenca, efikasiteti dhe lufta kundër korrupsionit duhet të jenë pjesë e kulturës. Ato duhet të mendohen si vlera themelore.”

MESAZH NGA KRYETARI Z. ILIR RUSI

HYRJE

Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) është organi qeverisës i gjyqësorit në Shqipëri, i krijuar në dhjetor të vitit 2018, me qëllim forcimin e integritetit dhe mirëqeverisjes së gjyqësorit në vend, në zbatim të objektivave të reformës kushtetuese. Veprimtaria e KLGJ-së është karakterizuar nga një vizion afatgjatë dhe i qartë mbi aspiratat e gjyqësorit, vizion i cili është konkretizuar në planet strategjike 2020-2022 dhe 2022-2024, si dhe planet përkatëse të veprimit.

Në funksion të krijimit të një sistemi gjyqësor funksional, të paanshëm, me integritet dhe me fokus qytetarin, KLGJ gjatë këtyre viteve është angazhuar për mbrojtjen e statusit të gjyqtarit, sigurimin e qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të administratës gjyqësore, trajtimin e çështjeve gjyqësore të prapambetura me masa emergjente, krijimin e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sigurimin e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë, rritjen e transparencës me qëllim kthimin e besimit të publikut te gjyqësori, rritjen e buxhetit me synim përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, ngritjen e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe krijimin dhe administrimin e hartës së re gjyqësore, që lejon vlerësimin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore në gjykata, dhe në fund, rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe aksesit në drejtësi për qytetarët.

Në kuadrin e transformimit rrënjësor të sistemit gjyqësor dhe me qëllim dhënien e drejtësisë pa vonesa dhe përmirësimin e efikasitetit të gjykatave, si edhe në vijim të zbatimit të plotë hartës së re gjyqësore, KLGJ miratoi Strategjinë “Për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, 2024 – 2027”. Kjo Strategji është në fillim të zbatimit të saj dhe përcakton përmasat e problemeve në gjykata, të cilat shkaktojnë volumin e madh të çështjeve të prapambetura, ofron një perspektivë për sa i përket skenarëve për pakësimin e tyre në tri vitet e ardhshme, si dhe prezanton masa praktike për uljen e çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen, duke ofruar, gjithashtu, një sërë masash ligjore të nevojshme për uljen e çështjeve të prapambetura dhe përmirësimin e efikasitetit të drejtësisë në gjykatat shqiptare. Strategjia përqendrohet kryesisht në gjykatat që kanë një numër tejet të lartë të çështjeve të prapambetura dhe konsiderohen gjykata në nevojë, ofron një projeksion të qartë mbi nivelin e uljes të numrit të këtyre çështjeve në varësi të rritjes së produktivitetit, si dhe parashikon një kuadër të përgjithshëm masash ligjore, strukturore dhe administrative, të cilat mund të përshtaten për çdo gjykatë.

Miratimi i Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Sistemit Gjyqësor në Shqipëri 2025 - 2027 është një tjetër masë e rëndësishme strategjike e ndërmarrë nga KLGJ-ja, që synon të përmirësojë dhe optimizojë funksionimin e sistemit gjyqësor shqiptar, me qëllim sigurimin e një administrimi më të shpejtë, më efikas dhe më transparent të drejtësisë. Udhërrëfyesi është një dokument strategjik thelbësor, sepse ofron një plan të strukturuar masash për të adresuar sfidat me të cilat përballlet aktualisht sistemi gjyqësor, duke maksimizuar potencialin e tij për përmirësim afatgjatë. Udhërrëfyesi thekson nevojën për reforma sistematike në fusha të tilla si përpunimi në kohë i çështjeve të reja, zvogëlimi i numrit të çështjeve të prapambetura, përdorimi i teknologjisë, zhvillimi dhe trajnimi i stafit të administratës gjyqësore dhe menaxhimi efektiv i gjykatave. Ai përfshin një qasje të strukturuar për të rritur efektivitetin, shpejtësinë dhe transparencën e sistemit gjyqësor. Objektivat dhe synimet e tij përqendrohen në përmirësimin

e efikasitetit të gjyqësorit dhe rritjen e besimit publik.

Me synimin që të sigurojë një qasje të standardizuar të gjykatave në marrëdhëniet e tyre me publikun dhe aktorë të tjerë, KLGJ miratoi Planin e Komunikimit me Gjykatën, 2022-2024. Ky Plan parashikon mjete dhe metoda konkrete të cilat gjykatat duhet t'i përdorin për një komunikim proaktiv, të kuptueshëm, që rrit transparencën, cilësinë e shërbimeve, profesionalizmin dhe ndikon në rritjen e besimit të publikut. Në kuadër të zbatimit të instrumenteve të reja të përafrimit të gjykatave me publikun dhe median, pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, KLGJ ka caktuar në çdo gjykatë të shkallës së parë, të juridiksionit të përgjithshëm apo të posaçëm, si dhe në gjykatat e apelit, një gjyqtar për marrëdhëniet me median dhe publikun duke e rritur kështu numrin e tyre në 17 gjyqtarë që drejtojnë dhe udhëzojnë komunikimin me median dhe publikun. Gjatë zbatimit të këtij plani, është miratuar një instrument i rëndësishëm për transparencën dhe komunikimin në gjykata, siç është Udhëzuesi Standard i Marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median. Aktualisht KLGJ është në fazën e përgatitjes së Planit të ri të Komunikimit 2025-2027.

Plani i ri Strategjik 2025-2027 përcakton synime gjithëpërfshirëse që synojnë të përforcojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit, duke siguruar që gjykatat të veprojnë të lira nga ndikimi i padrejtë dhe ndërhyrjet politike. Plani synon të modernizojë sistemin gjyqësor duke zbatuar zgjidhje dixhitale për të përmirësuar dhe përsheptuar procedurat gjyqësore, për të zhvilluar më tej menaxhimin e çështjeve dhe për të rritur transparencën.

Objektivat kryesore përfshijnë rritjen e efikasitetit të veprimtarisë gjyqësore për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura, duke siguruar drejtësi në kohë të arsyeshme për të gjithë qytetarët. Plani Strategjik gjithashtu thekson forcimin e integritetit dhe llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë përmes trajnimeve të dedikuara, vendosjes së standardeve etike dhe mekanizmave mbikëqyrës. Për më tepër, Plani Strategjik nënvizon rëndësinë e përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke mbështetur procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Besimi i publikut në gjyqësor është fokusi kryesor, me iniciativë të hartuara për të përmirësuar komunikimin, transparencën dhe aksesin ndaj shërbimeve gjyqësore.

Në përgjithësi, Plani pasqyron një angazhim për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të drejtë, transparent dhe efikas që mbështet sundimin e ligjit, mbron të drejtat e njeriut dhe nxit besimin e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Bazuar në praktikën tashmë të konsoliduar të ushtrimit të veprimtarisë bazuar në objektiva dhe qëllime të qarta strategjike, KLGJ filloi procesin për hartimin e planit të ri strategjik duke u bazuar në një metodologji të qartë e gjithëpërfshirëse, përmes së cilës anëtarët e KLGJ-së dhe drejtuesit e gjykatave të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve, diskutuan sfidat, problematikat, arritjet e sistemit gjyqësor si dhe dakortësuan objektivat strategjike për vitet 2025 - 2027. Në këtë proces, KLGJ-ja u mbështet në njohuritë e thella teknike të administratës dhe asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë.

Rezultati i këtij procesi është një plan strategjik që:

- a) përcakton misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike që do të udhëhiqnin veprimtaritë e KLGJ-së përgjatë viteve të ardhshme;
- b) identifikon dhe pasqyron nevojat e KLGJ-së, dhe nevojat e gjyqësorit në tërësi;
- c) ndihmon në përmbushjen e mëtejshme të synimeve të reformës në drejtësi; dhe
- d) jep një orientim për pushtetin ekzekutiv dhe atë legjislativ në ofrimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore në arritjen e objektivave.

Plani Strategjik i KLGJ-së është i harmonizuar me prioritetet e politikave kombëtare, si Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 - 2030, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2022-2030, që synon “ndërtimin e një vendi me një sistem drejtësie bazuar në llogaridhënie, transparencë që garanton pavarësi e qëndrueshmëri dhe ofron shërbime të ngjashme nga sektori i drejtësisë të BE-së. ” Po ashtu, Plani Strategjik adreson gjetjet e vëna në dukje nga raportet e fundit të Komisionit Evropian për Progresin e Shqipërisë, në lidhje me ecurinë e veprimtarive të institucioneve të reja e të pavarura gjyqësore dhe ndjekjen e një qasjeje sektoriale ndaj reformës në drejtësi, në kuadrin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2025-2030 dhe Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës. Plani Strategjik, gjithashtu reflekton prioritetet që lidhen me procesin e negociatave për integrimin në Bashkimin Europian, të parashikuara në dokumentin e politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, (në vijim “Agjenda e Reformës së BE-së”).

Ky plan strategjik, ashtu si edhe planet e tjera të hartuara nga KLGJ-ja, janë këshilluar me një gamë të gjerë palësh interesi duke përfshirë kryetarët e gjykatave, shoqërinë civile dhe Ministrinë e Drejtësisë (MD), etj.

Raportet e monitorimit dhe vlerësimit, të përcaktuara nga Plani Strategjik, ndihmojnë për të siguruar një zbatim të efektshëm të synimeve dhe objektivave të identifikuar. Gjatë zbatimit të planeve strategjike 2020 - 2022 dhe 2022 - 2024 , KLGJ-ja e ka përqendruar veprimtarinë e saj në adresimin e nevojave emergjente të sistemit gjyqësor, të cilat kishin të bënin kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore në gjykata, plotësimin e legjislacionit dytësor dhe hartimin dhe miratimin e nismave që synojnë konsolidimin e pushtetit gjyqësor. Tashmë Këshilli ka kaluar në fazën e konsolidimit, ruajtjes dhe përmirësimit të standardeve të vendosura, frymë e cila përshkon edhe hartimin e Planit të Veprimi të Planit Strategjik, si dhe metodologjinë përkatëse të monitorimit dhe vlerësimit.

PROGRESI I ZHVILLIMIT ORGANIZATIV

Faza e re në të cilën ka hyrë reforma në drejtësi kërkon konsolidimin e KLGJ-së si organ qeverisës. Struktura organizative e KLGJ-së aktualisht ka 162 punonjës. Ndërkohë, KLGJ ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për të garantuar efektivitetin e veprimtarisë së KLGJ-së dhe gjykatave, dhe konsolidimin e praktikave të mira të organizimit dhe funksionimit të burimeve njerëzore.

Si organi qeverisës i pushtetit gjyqësor, KLGJ-ja mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtësisht me gjykatat, për të siguruar forcimin e zhvillimit organizativ të vazhdueshëm, krahas konsolidimit të rezultateve të reformës në drejtësi. Në rrugëtimin e tyre drejt

konsolidimit, KLGJ-ja dhe gjykatat do të mbështeten në vlerat themelore të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, themele këto që do t'i ndihmojnë për të adresuar sfidat e shumta që lidhen me rikthimin e funksionalitetit të gjykatave të apeleve, plotësimin e vakancave, përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, rritjen e produktivitetit dhe rikthimin e besimit të publikut. Nga krijimi e deri tani, KLGJ-ja ka vijuar të ripërtërihet me anëtarë të rinj nga gjyqësori, shoqëria civile, avokatia dhe akademja. Sistemi i rotacionit, pavarësisht vonësive në zbatimin e tij, ka bërë të mundur kombinimin e eksperiencës së anëtarëve më të vjetër në detyrë me vizionin dhe energjitë e anëtarëve të rinj, të cilët i janë bashkuar KLGJ-së në vitet 2022, 2023 dhe 2024. Ky proces ripërtëritjeje është shoqëruar me angazhimin maksimal për vijimin e veprimtarisë së KLGJ-së dhe përmbushjen e objektivave strategjike.

Periodha 2025-2027 përkon me kohën kur sistemi gjyqësor duhet të hyjë në rrugën e funksionalitetit të plotë dhe konsolidimit, si edhe me fazën e tretë të zbatimit të reformave madhore, që synojnë: 1) *eliminimin e backlog-ut*, 2) *rritjen e cilësisë së shërbimeve* dhe 3) *ofrimin e një drejtësie në nivelin dhe standartet e BE-së*.

Gjatë periudhës së ardhshme, kur procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve të ketë përfunduar, KLGJ synon të bëjë të mundur emërimin në kohë të Kryetarëve të Gjykatave dhe forcimin në lidhshmëri të këshillave të gjykatave, duke përfshirë caktimin në detyrë në mënyrë përfundimtare të kancelarëve. Këto angazhime do të vijnë të mbështeten nga administrata e KLGJ-së dhe ajo e gjykatave, të cilat ushtrojnë funksionet në përputhje me vizionin për një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, transparent, llogaridhënës e në shërbim të qytetarëve. Përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe pritshmërive të publikut mbetet prioritet i KLGJ-së.

METODOLOGJIA DHE PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Rreth nëntë vjet pas miratimit të reformave madhore në sistemin e drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet një ndër institucionet që shënoi një pikë kthese në menaxhimin dhe riorganizimin e përgjithshëm të gjyqësorit të Shqipërisë. KLGJ-ja ka vijuar punën intensive për të trajtuar me përparësi veprimtaritë e saj, planifikuar vendimmarrjen, si dhe për të ndërmarrë hapat e duhur lidhur me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Shpejtësia dhe efikasiteti për të plotësuar në kohë nevojat e sistemit gjyqësor në interes të qytetarëve shqiptarë, kanë qenë parimet që kanë udhëhequr veprimtarinë e KLGJ-së.

Puna përgatitore për hartimin e këtij Planit të ri Strategjik për të gjithë gjyqësorin, konsistoi në identifikimin dhe vlerësimin e pikave të forta e të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve të veprimtarisë së KLGJ-së dhe pushtetit gjyqësor. Konsultimi me grupet e interesit, me qëllim identifikimin e fushave ku ka nevojë për ndërhyrje strategjike, ishte një vlerë e shtuar e procesit. Procesi i konsultimit përfshiu takime dhe shkëmbim idesh me përfaqësues të gjyqësorit, Ministrisë së Drejtësisë, shoqërisë civile si dhe komunitetit të biznesit.

Procesi i hartimit të Planit të ri Strategjik të KLGJ-së ndodhi në të njëjtën kohë me procesin e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2025-2030 (SND), proces i cili u drejtua nga Ministria e Drejtësisë (MD). SND III u mbështet në plane veprimi të veçanta, që korrespondojnë me objektivat specifike dhe vishnin me përgjegjësi individuale secilin institucion të sistemit të drejtësisë për zbatimin e tyre. KLGJ-ja dhe MD-ja i kanë koordinuar përpjekjet e tyre për të siguruar që të dy dokumentet strategjik të ishin në përputhje dhe të lidhura, për aq sa është e mundur, me njëra-tjetrën.

Me këtë plan të përditësuar 2025 - 2027, Këshilli synon të përcaktojë drejtimin strategjik të gjyqësorit për periudhën e ardhshme, duke marrë me kujdes në konsideratë faktorët që mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e përshkruara në këtë strategji.

Përgjatë viteve të ardhshme, KLGJ-ja është e angazhuar të vijojë të forcojë rolin e saj si organi qeverisës dhe udhëheqës i sistemit gjyqësor në Shqipërinë. Këshilli do të vazhdojë ta përsosë edhe më shumë fokusin e tij dhe të bëjë zgjedhje strategjike, sa herë që do të bëhet fjalë për të adresuar problemet më të rëndësishme, me të cilat përballlet sistemi gjyqësor në Shqipëri.

Duke e kuptuar qartë këtë rol thelbësor, Këshilli angazhohet edhe një herë në një proces dinamik të planifikimit strategjik, për të përcaktuar një të ardhme ku qytetarët, gjyqësori dhe qeveria i koordinojnë përpjekjet e tyre drejt fuqizimit të politikave dhe praktikave gjyqësore të Shqipërisë dhe arritjes së rezultateve që kontribuojnë në vendosjen e besimit të publikut.

KLGJ-ja luan një rol jetik, duke shërbyer si zëri për sundimin e ligjit dhe duke advokuar në çdo shkallë të gjyqësorit për të ndërmarrë reformat e duhura, të cilat udhëhiqen nga vlerat. KLGJ-ja është e angazhuar që të punojë në partneritet me Këshillin e Ministrave, Kuvendin, e Shqipërisë, partnerët për zhvillim, gjyqtarët dhe natyrisht, qytetarët, për të bërë investime strategjike, të cilat çojnë drejt një sistemi gjyqësor efikas dhe të respektuar duke përmbushur objektivat kombëtare për integrimin në Bashkimin Europian.

Gjatë kohës kur po hartohet ky plan, KLGJ-ja ka diskutuar një sërë çështjesh kontekstuale dhe sfidash aktuale të cilat duhet të përcaktojnë prioritetet e planit, mes të cilave përfshihen:

- a) reputacioni historik i gjyqësorit dhe perceptimi i publikut;
- b) stoku prej 21.000 çështjesh të prapambetura në Gjykatë të Lartë;
- c) stoku prej 65 056 çështjesh të prapambetura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (41 158) dhe Gjykatës Administrative të Apelit (23 898);
- d) ritmi i ndryshimeve teknologjike dhe impakti i tyre mbi funksionimin e gjyqësorit;
- e) kufizimet e buxhetit dhe nevojat infrastrukturore;
- f) vakancat e gjyqtarëve dhe mungesa në burimet njerëzore mbështetëse në gjykata;
- g) burimet e disponueshme të financimit për sistemin gjyqësor;
- h) trajnimi i vazhdueshëm i nëpunësve civilë gjyqësorë jo vetëm për të përmirësuar performancën e tyre, por edhe në çështje të tilla si etika apo antikorrupsioni;
- i) kufizimet në legjislacionin aktual dhe miratimi në kohë i ndryshimeve ligjore të përcjella në kuvend;
- j) çështjet që lidhen me aderimin në Bashkimin Evropian;
- k) vijimi i ushtrimit të kompetencave specifike për vlerësimin kalimtar të magjistratëve, pas përfundimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Prandaj, efektet e mundshme që këto çështje mund të kenë në të ardhmen e gjyqësorit janë pasqyruar si faktorë edhe në këtë plan strategjik.

PLANI STRATEGJIK 2025-2027

MISIONI:

Misioni i KLGJ-së është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

VIZIONI:

Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.

VLERAT THEMELORE TË GJYQËSORIT

Pavarësia

KLGG-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor që funksionon si një organ i pavarur, i pandikuar nga ndërhyrjet dhe i angazhuar ndaj sundimit të ligjit.

Integriteti

KLGG-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem të ndershëm gjyqësor që vepron në përputhje me parimet më të larta morale dhe etike dhe që gjithmonë përpiqet të bëjë drejtësi.

Profesionalizmi

KLGG-ja dhe gjykatat zotohen të ndërtojnë një sistem gjyqësor, anëtarët e të cilit i zotërojnë të gjitha aftësitë e nevojshme për të përmbushur më së miri rolin e tyre.

Paanshmëria

KLGG-ja dhe gjykatat zotohen të trajtojnë të gjithë qytetarët si të barabartë përpara ligjit.

Llogaridhënia

KLGG-ja dhe gjykatat zotohen të garantojnë që të gjithë anëtarët e gjyqësorit janë të gatshëm të marrin përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre.

Akresi, Efektshmëria, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Trajtimi i Drejtë, Besueshmëria, Respekti, Përgjegjshmëria dhe Transparenca.

Palët e interesit: Anëtarë të gjyqësorit që punojnë për të ndërtuar një sistem profesional, efikas, llogaridhënës dhe novator, duke zbatuar praktikën më të mira ndërkombëtare.

Shërbimet: Udhëzime të qarta dhe praktike, mbështetje dhe instrumente që përmirësojnë ofrimin e shërbimeve gjyqësore, efikasitetin e administrimit të gjykatave, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët.

Shtrirja/Mbulimi: Një zë kombëtar i qëndrueshëm dhe i respektuar. **Partneriteti:** Institucionet e sistemit të drejtësisë, degët e tjera të pushtetit, media, partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë për zhvillim dhe shoqëria civile.


Përfituesit: Individët që gëzojnë të drejtën për një gjyqësor të drejtë dhe të pavarur, që është i aftë të ofrojë shërbime gjyqësore me cilësinë më të lartë.

- Përmes angazhimit në mënyrë proaktive dhe ofrimit të udhëheqjes së saj në proceset e hartimit të politikave, zhvillimit të planeve, marrjes së vendimeve kyçe dhe akordimit të burimeve të nevojshme për gjyqësorin.
- Përmes përdorimit të praktikave më të mira ndërkombëtare për zbatimin e masave me ndikim të lartë në çdo nivel, duke nisur me rikthimin e funksionalitetit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Përmes ofrimit të mbështetjes thelbësore drejtuesve të gjykatave, institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë, pushteteve të tjera qeverisëse dhe shoqërisë civile.
- Krijimi i marrëdhënieve me nivel të lartë besimi dhe bashkëpunimi me vendimmarrësit kyç.
- Kuptimi i drejtë i proceseve vendimmarrëse në gjyqësor.
- Përvojë dhe ekspertizë e plotë dhe me rëndësi për sistemin gjyqësor.
- Aftësi në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me median dhe publikun, me qëllim për të garantuar aksesin në drejtësi dhe të drejtën e informimit në mënyrë proaktive.
- Mbajtja e marrëdhënieve të ngushta dhe të qëndrueshme me një sërë partnerësh ndërkombëtarë dhe lokalë për zhvillim.
- Konsolidimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe llogaridhënëse karshi vlerave tona dhe e përkushtuar për përmirësim të vazhdueshëm.
- Krijimi i strukturave dhe sistemeve të efektshme dhe efikase që shfrytëzojnë plotësisht aftësitë dhe profesionalizmin e anëtarëve të KLGJ-së.
- Formulimi i programeve të qarta për krijimin dhe administrimin e partneriteteve.
- Role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për palët e interesit.
- Aftësia për të ofruar shërbime që sjellin mbështetje të qëndrueshme financiare.
- Parametra të qarta për matjen e impaktit dhe efektshmërisë së punës tonë.

ANALIZA SWOT

Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet

Gjatë procesit të planifikimit strategjik, KLGJ vlerësoi fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e institucionit, përmes një analize SWOT. Ky proces siguroi informacion me vlerë, lidhur me çështjet aktuale dhe të mundshme, që mund të prekin KLGJ-në dhe gjyqësorin. Analiza SWOT i erdhi në ndihmë Këshillit për të kuptuar më mirë kontekstin mjedisor, si dhe të reflektojë nisur nga përfundimet e nxjerra gjatë periudhës së planifikimit të mëparshëm strategjik të Këshillit.




SYNIMET STRATEGJIKE 2025 -2027

Gjatë viteve të ardhshme, gjyqësori do të vijojë t'i përqendrojë përpjekjet e tij në pesë synime strategjike parësore të cilat përputhen me vizionin, misionin, vlerat dhe kaskadën e strategjisë, të përcaktuar më lart.

Synimet dhe objektivat e përcaktuar në këtë plan janë ambicioze dhe dëshmojnë qartësisht që KLGJ po hyn tashmë në një fazë më të konsoliduar, qasje që do të drejtojë qëllimet e gjyqësorit deri në fund të vitit 2027.

Në planin e veprimit që shoqëron këtë dokument, KLGJ-ja planifikon të përdorë një sërë treguesish për matjen e performancës, të cilat shërbejnë për të vlerësuar ecurinë drejt secilit synim, si dhe drejt objektivave të strategjive të lidhura me to. Matjet e performancës do të monitorohen dhe përditësohen bazuar në zhvillimin e objektivave dhe shkallën e realizimit të tyre brenda afatit kohor të përcaktuar. Informacioni apo të dhënat sasiore dhe cilësore, do të mbledhen, shqyrtohen dhe analizohen me qëllim për të kuptuar më mirë impaktin e zbatimit të këtij plani në përmbushjen e synimeve madhore të KLGJ-së për sistemin gjyqësor në vend.

KLGJ-ja beson se, gjatë viteve të ardhshme, është e rëndësishme të tregojë vendosmëri për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të gjitha nivelet. Pesë synimet e mëposhtme janë hartuar me qëllim trajtimin e fushave me problematikat më urgjente.



SYNIMI 1: Rritja e Aksesit në Drejtësi përmes Sigurimit të Funkcionalitetit të plotë të Gjykatave dhe Akordimit të Burimeve

Sigurimi sa më shpejt të jetë e mundur, i burimeve të përshtatshme për zbatimin me efektivitet të reformave të pushtetit gjyqësor përmes rikthimit në funksionalitet të plotë të gjykatave, përfshirë infrastrukturën dhe personelin gjyqësor, duke i kushtuar rëndësi cilësisë.

KLGGJ-ja është e vetëdijshme se sistemi gjyqësor duhet të funksionojë mbi parimet e efikasitetit dhe efektshmërisë dhe për këtë qëllim, duhet punuar pa u ndalur përballë pengesave për t'i trajtuar këto çështje si prioritetet më urgjente të gjyqësorit për të garantuar aksesin e qytetarëve.

SYNIMI 2: Zbatimi dhe Monitorimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore

Angazhimi për zbatimin e praktikave më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke u përqendruar në standardet që sigurojnë cilësi gjyqësore.

KLGGJ-ja është e vetëdijshme se ekselencia nuk është ende një karakteristikë që mund të përdoret për të përshkruar gjyqësorin shqiptar. Ndërkohë që progresi vazhdon me ritme të qëndrueshme, KLGGJ-ja angazhohet të sigurojë që gjyqësori të ketë gjyqtarë dhe personel administrativ që përmbush standarde rigoroze etike, me njohuri të thella në legjislacionin shqiptar dhe që vlerësohet bazuar në standardet më të larta profesionale.

SYNIMI 3: Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funksionimi më i Mirë i Gjykatave

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes zbatimit dhe monitorimit të Hartës Gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale.

KLGGJ-ja është në dijeni të situatës ku infrastruktura gjyqësore (ndërtesat dhe mjediset e punës) e sistemet e teknologjisë së informacionit janë vjetëruar dhe janë shpesh jofunksionale. KLGGJ-ja angazhohet të marrë hapat e nevojshëm për të ngritur dhe mirëmbajtur një sistem të sigurt, funksional, efikas dhe të mirëadministruar të teknologjisë së informacionit, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të qeverisjes.

SYNIMI 4: Fuqizimi i Kapaciteteve Profesionale dhe Efikasitetit të KLGGJ-së

Përcaktimi i qartë i rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij dhe dhënia përparësi ndaj fuqizimit institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë dhe efikasitetit, përfshirë kërkimin e burimeve të përshtatshme buxhetore.

KLGG-ja zotohet të konsolidojë themelet e punës së saj dhe të vazhdojë një ndërtim të sigurt “të godinës” së drejtësisë shqiptare. Kjo lidhet me krijimin e strukturave dhe me plotësimin me personel që pasqyron vlerat e institucionit, përfshirë këtu një administratë të përbërë nga specialistët më të talentuar dhe të palodhur në administrimin e gjykatave.

SYNIMI 5: Zbatimi dhe Përmirësimi i Strategjive për Komunikimin e Jashtëm

Përmirësimi i ndërveprimit midis gjyqësorit, partnerëve tanë dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.

KLGG-ja zotohet të veprojë me transparencë duke siguruar që si media, ashtu edhe publiku të jenë plotësisht të informuar mbi ndryshimet në gjyqësor.

SYNIMI 1: <i>Rritja e Aksesit në Drejtësi përmes Sigurimit të Funksionalitetit të plotë të Gjykatave dhe Akordimit të Burimeve</i>	1.1 Rivënia në funksionim të plotë i gjykatave të apelit (Juridiksioni i Përgjithshëm dhe i Posaçëm). 1.2 Adresimi i nevojave infrastrukturore dhe administrative (burimeve njerëzore) në të gjitha gjykatat dhe veçanërisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. 1.3 Reduktimi i numrit të çështjeve të prapambetura për sistemin gjyqësor. 1.4 Rishikimi i kuadrit ligjor dhe plotësimi i kuadrit nënligjor sipas përcaktimeve të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi.
SYNIMI 2: <i>Zbatimi dhe Monitorimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore</i>	2.1 Përcaktimi i standardeve për ekselencë gjyqësore dhe miratimi i akteve të nevojshme nënligjore. 2.2 Rritja e performancës së trupës gjyqësore dhe administratës gjyqësore përmes vlerësimit periodik të veprimtarisë profesionale në përputhje me planin e vlerësimit, afatet dhe kuadrin nënligjor në fuqi. 2.3 Forcimi i mekanizmave monitorues për zbatimin e etikës profesionale nga gjyqtarët dhe personeli i administratës së gjykatave.
SYNIMI 3: <i>Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funksionimi më i Mirë i Gjykatave</i>	3.1 Monitorimi i zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë. 3.2 Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore për të përmbushur standardet bashkëkohore. 3.3 Zhvillimi i sistemit të ri elektronik të

	unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. 3.4 Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga gjykata përmes digjitalizimit. 3.5 Forcimi i kapaciteteve të Qendrës së TI-së të sistemit të Drejtësisë. 3.6 Fuqizimi i ndërveprimit të KLGJ-së me gjykatat dhe legjislativin për zbatimin e Strategjisë të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura, 2024 -2027 dhe Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor, 2025 -2027 3.7 Përmirësimi i funksionimit të gjykatave në të gjitha shkallët, përmes monitorimit të efikasitetit të gjykatave për përmirësimin e rendimentit dhe zgjedhjen e drejtuesve të tyre. 3.8 Përmirësimi i kapaciteteve organizative të KLGJ-së dhe gjykatave për t'iu përgjigjur situatave të krizave dhe për të ruajtur funksionalitetin në masën më të madhe të mundshme. 3.9 Forcimi i bashkëpunimit me organet kolegjiale të gjykatave
SYNIMI 4: Fuqizimi i Kapaciteteve Profesionale dhe e Efikasitetit të KLGJ-së	4.1 Rritja e kapaciteteve të KLGJ-së për të përballuar me sukses sfidat e sistemit gjyqësor. 4.2 Forcimi i kulturës novatore në qeverisjen e sistemit gjyqësor që merr në konsideratë zhvillimet e teknologjisë dhe sfidat. 4.3 Përmirësimi dhe institucionalizimi (nëpërmjet ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës, nënshkrimit të MoU, etj) i bashkëpunimit të KLGJ me institucione apo organizata të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. 4.4 Fuqizimi/ Rritja e vazhdueshme e rolit të KLGJ-së në hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit që rregullon punën e gjyqësorit. 4.5 Miratimi i Rregullores së Brendshme për

	organizmin dhe funksionimin e KLGJ. 4.6 Miratimi i rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit të anëtarëve
SYNIMI 5: Zbatimi dhe Përmirësimi Strategjive për Komunikimin e Jashtëm	5.1 Rritja e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor. 5.2 Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie proaktive, transparente e informuese. 5.3 Fuqizimi i ndërveprimit të KLGJ-së me gjykatat për zbatimin e planit të komunikimit për sistemin gjyqësor.

MONITORIMI, LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Strukturat dhe Qasja

Në hartimin e këtij plani strategjik për të gjithë sistemin gjyqësor në Shqipëri, Këshilli njihet rëndësinë që ka zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i kujdesshëm i veprimtarive të tij. Në përpjekjen për të prioritetizuar këto veprimtari, strukturat përkatëse të Këshillit do të monitorojnë në vazhdimësi ecurinë, rishikojnë drejtimin strategjik, dhe zbatimin e vetë strategjisë. Strukturat do të mbledhin të dhëna dhe informacione të rëndësishme në lidhje me zbatimin e strategjisë dhe kur është e mundur, sugjerojnë ndryshime në strategji, tregues dhe/ose instrumente matëse.

Strukturat për monitorimin e zbatimit të strategjisë janë struktura të përkohshme dhe me anëtarësi fluide, të cilat caktohen në bazë të nevojave të Këshillit për mbikëqyrje. Duke qenë se objektivat dhe masat përkatëse mund të ndryshojnë në kohë, përbërja e këtyre strukturave duhet të jenë të ndryshueshme.

Kërkesat për Raportim

Strukturat e KLGJ-së për monitorimin e zbatimit të strategjisë janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave strategjike.

Ky proces e pajis Këshillin me një instrument për monitorimin dhe kontrollimin e vetë sistemeve të brendshme, proceseve dhe progresit në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të parashtruar në planin strategjik.

Strukturat monitoruese janë përgjegjëse për hartimin e raporteve të punës tremujore deri në përfundim të afatit të kësaj strategjie. Këto raporte ofrojnë një tablo të qartë të ecurisë së Këshillit në zbatimin e strategjisë, si dhe në përqendrimin e vëmendjes në ato çështje që mund ta pengojnë zbatimin e saj.

Në funksion të matjes së rezultateve, strukturat e monitorimit të strategjisë do të hartojnë dy herë në vit (çdo gjashtë muaj) një matricë vlerësimi që shpjegon më tej progresin në zbatimin e strategjisë, apo, sipas rastit, arsyet për devijimin nga plani i miratuar i veprimit. Matësit e përdorur gjatë procesit të planifikimit pasqyrojnë mësimet e rëndësishme që Këshilli nxori gjatë dy periudhave të planifikimit strategjik.

Duhet vënë në dukje se Këshilli i kushtoi një vëmendje të madhe zhvillimit të treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë për secilin zë të planit strategjik dhe të planit të veprimit. Shumë prej këtyre treguesve pasqyrojnë qëllimisht treguesit e parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe kanë si qëllim bashkërendimin e punës së Gjyqësorit dhe Ministrisë së Drejtësisë si edhe në Udhërrëfyesin për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025 - 2027. Këto tregues do të drejtojnë strukturën e monitorimit për matjen e progresit gjatë procesit të vlerësimit dhe monitorimit.

Akresi te të Dhënat e Monitorimit dhe Vlerësimit

Strukturat e monitorimit janë përgjegjëse për dorëzimin e të gjitha raporteve për rishikim dhe miratim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Të gjitha raportet publikohen në faqen zyrtare të Këshillit në internet.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit është përgjegjës për rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo vit për të garantuar përputhshmërinë gjatë punës me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Shtojca A: Pjesëmarrësit në Procesin e Planifikimit Strategjik

Hartimi i këtij Plani Strategjik nuk do të kishte qenë i mundur pa angazhimin e jashtëzakonshëm të një grupi të ndërthurur pjesëmarrësish dhe të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Ilir Rusi, Kryetar

Yllka Rupa, Zëvendëskryetare

Irena Plaku, anëtare

Ridvan Hado, anëtar

Klodian Kurushi, anëtar

Markelian Koça, anëtar

Emona Muçi, anëtare

Gentjana Muçaj, anëtare

Violanda Theodhori, anëtare

Albens Tabaku, anëtar

Bledar Bajri, anëtar

Këshilli dhe stafi i tij administrativ vlerësojnë kontributin dhe asistencën që anëtarët e gjyqësorit, të cilët përfaqësonin të gjitha instancat e gjykatave, ato të juridiksionit të përgjithshëm, administrativ dhe të posaçme, dhanë gjatë hartimit të këtij plani.

Një falënderim të posaçëm për partnerët ndërkombëtarë Projektin EU4Justice për ekspertizën dhe mbështetjen teknike të ofruar nëpërmjet eksperteve ligjore vendase Olta Lolo dhe Valbona Bala (Pajo).

